



Datë: 04.02.2026

Numër Protokolli: 665/2026

A.nr.1377/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtar, më Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1377/2025, të datës 16.07.2025, të parashtruar nga ankuesit: B.P, A.S, A.K dhe A.R, të cilët me autorizim të përbashkët i përfaqëson ankuesi B.P, kundër organit të punësimit: Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike *“kërkesë nga marrëdhënia e punës”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1377/2025, e datës 16.07.2025, e parashtruar nga ankuesit B.P, A.S, A.K dhe A.R.
- II. Obligohet** Kryetari dhe Njësia e Personelit të Komunës së Prishtinës, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet administrativ në kuptim të njohjes së drejtës së ankuesit në rregullim të koeficientit sipas nenit 33 të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, si dhe të bëjë kompensimin e diferencës së paguar për periudhën janar 2025 e deri në zbatim të këtij vendimi.
- III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet lidhur më veprimet e ndërmarra sipas pikës II të dispozitivit.

A r s y e t i m

Ankuesit si në preambulë të këtij vendimi, më datë 16.07.2025, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes në kërkesë me numër Referencë: 14-117/01-80021/25/, të datës 16.06.2025, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, për shkak të aplikimit të gabuar të ligjit material dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4751/2025, të datës 16.07.2025, e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 23.04.2025; Kopjen e ID-së së ankuesit B.P; Kërkesën e datës 09.06.2025 të parashtruar nga ankuesit tek Kryetari i Komunës së Prishtinës; Përgjigjen në kërkesë me numër Referencë: 14-117/01-80021/25/ të datës 16.06.2025 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Kontratat e punës për kohë të caktuar e datës 16.05.2024 për ankuesit; Kopjet e ID-së për të gjithë ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesit është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimit i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesit kanë themeluar marrëdhënie punë me Komunën e Prishtinës, dhe atë për kohë të caktuar, për realizimin e një projekti ashtu që ankuesit **B.P**, në pozitën e punës Zyrtar mbështetës në Sektorin e Bujqësisë në Drejtorinë e Bujqësisë, kategoria Profesional 2 dhe koeficient të pagës Gj33-5.1; A.S, në pozitën Zyrtar mbështetës -Projekt në Drejtorin e Bujqësisë, , kategoria Profesional 3 dhe koeficient të pagës Gj41-4, A.K, në pozitën e punës Zyrtar mbështetës në Sektorin e Bujqësisë në Drejtorinë e Bujqësisë, kategoria Profesional 2 dhe koeficient të pagës Gj33-5.1 dhe A.R, në pozitën e punës Zyrtar mbështetës në Sektorin e Bujqësisë në Drejtorinë e Bujqësisë, kategoria Profesional 2 dhe koeficient të pagës Gj33-5.1, që të gjithë për një periudhë tri (3) vjeçare.

Tutje, sipas shkresave të lëndës, rezulton se ankuesit më datë 09.06.2025, i janë drejtuar me kërkesë Kryetarit të Komunës së Prishtinës, përmes të cilës kanë kërkuar realizimin e pagave sipas Vendimit të datës 29.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, më të cilin është miratuar rritja e koeficientit për njësi prej për 0.5 apo në vlerën e shumës prej 55 Euro.

Menaxheri i Burimeve Njerëzore, të Komunës së Prishtinës, përmes përgjigjes në kërkesë me numër Reference: 14-117/01-80021/25/ të datës 16.06.2025, ka njoftuar ankuesit se marrëdhënia e punës e themeluar është me kontratë të caktuara për realizimin e një projekti dhe sipas nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar, është përcaktuar: *Përshkrimi i projektit sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë të paktën kohëzgjatjen e projektit, koston e detajuar, numrin e punëtorëve që do të angazhohen, pagesën e tyre, dhe kjo pagesë bëhet në bazë të kostot të përcaktuar për periudhën sa është edhe marrëdhënia e punës.*

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se kontratat e punës janë të rregulluar me nenin 37 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 dhe paragrafi 5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe përderisa paguhemi me koeficient sipas kontratës, karshi kësaj duhet të bëhet edhe ndryshimi i vlerës së koeficientit në pajtim më nenin 33 të Ligjit Nr.08/L-332 për ndarjet Buxhetore për vitin 2025. Kërkojnë që ankesa të aprovohet dhe të obligohet Komuna e Prishtinës të bëjë rregullimin e koeficientit duke e shtuar edhe rritjen prej 55 Euro nga data 01.01.2025 në mënyrë retroaktive nga janari 2025 e tutje.

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë me theks të veçantë nenit 22 dhe 37, i cili përcakton:

Neni 22 [E drejta e pagës: *Për orët e punës së kryer, zyrtarja/i publik ka të drejtën e pagës. Paga e zyrtares/it publik rregullohet me Ligjin përkatës për Pagat në Sektorin Publik.*

Neni 37 [Marrëdhënia e punës në shërbimin civil] *1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji. 2. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj. 3. Përfundimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar në këto raste: 3.1. për realizimin e projektit të caktuar të institucionit përkatës; 3.2. për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme. 4. Kontrata e punës për periudhë të caktuar sipas paragrafit 3. të këtij neni, lidhet për aq sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se tre (3) vite për kontratën sipas nën-paragrafit 3.1. të këtij neni dhe jo më të gjatë se dy (2) vite për kontratën sipas nën-paragrafit 3.2. të këtij neni. 5. E/i punësuar/i me kontratë sipas paragrafit 3. të këtij neni, gëzon të drejtat dhe detyrimet e njëjta sikurse të gjithë nëpunësit civil, me përjashtim të së drejtës për vazhdim të kontratës së përkohshme, pa iu nënshtruar procedurës së rregullt të rekrutimit.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, në trajtimin e drejtë të kësaj çështje juridike-administrative mori parasysh edhe përcaktimet ligjore sipas Rregullores (QRK) Nr. 03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar, gjegjësisht me nenin 4, përcaktohet: *1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar në këto raste: 1.1. për realizimin e projektit të caktuar të institucionit përkatës; 1.2. për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme. 2. Kontrata e punës për periudhë të caktuar lidhet për aq sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se tre (3) vite për kontratën sipas nënparagrafit 1.1 të këtij neni dhe jo më të gjatë se dy (2) vite për kontratën sipas nënparagrafit 1.2. të këtij neni. 3. I punësuar i me kontratë sipas këtij neni, nuk gëzon të drejtën për vazhdim të kontratës së përkohshme, që tejkalon afatin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni. Ndërsa, më nenin 5 të kësaj rregulloreje, parashihet se: 1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar për realizimin e një projekti të caktuar. 2. Projekti sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të aprovohet nga titullari dhe të ketë mbulesë financiare në buxhet. 3. Përshkrimi i projektit sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë të paktën kohëzgjatjen e projektit, koston e detajuar, numrin e punëtorëve që do të angazhohen, pagesën e tyre....”*

Referuar kuadrit ligjor si më lartë, Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave materiale të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur së Komuna e Prishtinës ka miratuar Projektin më titull”: *Trajtimi i ndërtimeve pa leje”, afati i realizimit të projektit në fjalë është 36 muaj (3 vite) dhe së numri i kërkuar për realizimin e këtij projekti ka qenë 43 zyrtarë dhe atë: Zyrtarë i Lartë për Arkitekturë, 23 pozita; Zyrtar i Lartë për Ndërtimtari, 1 pozitë; Zyrtar i Lartë për Hidro, 1 pozitë; Zyrtar i Lartë për Elektrikë, 2 pozita; Zyrtar për Makineri, 2 pozita; Zyrtar i Lartë për Komunikacion, 1 pozitë’ Zyrtar Për Adresa, 1 pozitë; Zyrtar i Lartë për Gjeodezi, 3 pozita; Zyrtar për Çështje Juridike, 4 pozita; dhe Zyrtar mbështetës, 4 pozita. Rrjedhimisht, si rezultat i implementimit të projektit, ankuesit ishin përzgjedhur si nëpunës civilë me kontratë të caktuar sipas procedurës së pranimit më nr.ref: RN00014049.*

Andaj, në kuptim të bazës ligjore si më lartë si dhe duke u bazuar edhe në vet kontratat e punës së ankuesve, konstatohet së ankuesit realizojnë pagë sipas koeficienteve të pagave të përcaktuara me Ligjin për Paga në Sektorin Publik, kështu që, në vlerësimin e Kolegjit, të punësuarit për realizimin e projektit të caktuar të institucionit përkatës gëzojnë çdo të drejtë dhe detyrim si të gjithë nëpunësit civil, duke nënkuptuar edhe çdo të drejtë dhe detyrim ligjor ndërlidhur me pagën. Pra, në këtë kontekst, ankuesit kanë të drejtë në realizimin e pagës sipas klasës dhe koeficienti të përcaktuar për pozitën përkatëse sipas shtojcave të Ligjit nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, përfshirë edhe çdo rritje të vlerës së koeficientit siç përcaktohet me nenin 9 të këtij ligji.

Referuar si më lartë, Kolegji erdhi në përfundimin se pretendimet ankimore të ankuesve janë të bazuara, dhe në kuptim të nenit 18, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitave të këtij vendimi, në fakt, aprovoj ankesën si të bazuar duke obliguar Kryetarin dhe Njësia e Personelit të Komunës së prishtinas, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet administrativ në kuptim të njohjes së drejtës së ankueses në rregullim të koeficientit sipas nenit 33 të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, si dhe të bëjë kompensimin e diferencës së paguar për periudhën janar 2025 e deri në zbatim të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1377/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve B.P;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.